



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 677/1 prot.

Tiranë, më 31. 08. 2020

V E N D I M

Nr. 96, datë 31. 08. 2020

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 46, datë 05.06.2020, e shtetasit B. M., kundër Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të bindjeve politike¹ dhe çdo shkak tjetër²*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi sqaron se, prej rreth 7 vitesh është punonjës i RTSH-së, në pozicionin e Specialistit të IT-së. Me emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, TH. G., ndryshuan edhe një pjesë e drejtuesve të drejtorive të RTSH-së, ndër të cilët edhe eprori direkt i ankuesit, Drejtori i Njësisë Teknike.

Për zbatimin e Urdhërit Nr. 75/11 prot., datë 21.12.2018 “Për krijimin e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallrave të kontratës ‘Blerje licencë për përdorues në sistemin Mam Etere dhe Playout, si dhe Suport (MNSH)’”, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, ka caktuar ankuesin së bashku me 2 kolegë të tij. Në këto kushte, ankuesi si drejtues i grupit ka hartuar një procesverbal, drejtuar Drejtorit të Planifikimit dhe Prokurimeve, në të cilin ka kërkuar plotësimin

¹ Për shkak të anëtarësimit të tij në subjektin politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”, vërtetuar me anë të Kartës së Anëtarësimit lëshuar më date 03.06.2020.

² Për shkak të kundërshtimit të eprorëve

e disa mangësive në mënyrë që të zbatojë urdhrin e sipërcituar të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

Sipas ankuesit, në vijim ai është thirrur nga ana e Drejtuesit të Njesisë Teknike dhe është kërcënuar duke ju drejtuar me shprehjen *“Çfarë inxhinieri je ti, ti nuk duhet të punosh në RTSH”*. Pas këtij momenti ankuesi pretendon se situata diskriminuese është intensifikuar. Fillimisht, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, ka thirrur në mbledhje anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim dhe në formë presioni ka kërkuar pranimin e kontratës. Në kushtet që ankuesi ka kundërshtuar sërish, është anuluar Urdhri Nr. 75/11 prot., datë 21.12.2018 dhe është urdhëruar ngritja e një grupi të ri, ku në rolin e kryetarit ishte Përgjegjësi i Njesisë Teknike, A. K. Sipas ankuesit, nën trysinë e eprorëve, anëtarët e komisionit kanë pranuar kontratën, ndërsa ai sërish ka kundërshtuar duke bërë objeksionet e tij.

Në muajin Qershor 2019, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së në bashkëpunim me Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, A. M., kanë shkarkuar nga detyra e Përgjegjësit të Njesisë Teknike, A. K. dhe kanë emëruar në këtë pozicion E. B. Pas emërimit të tij në këtë pozicion, me synim largimin nga detyra të ankuesit, i janë caktuar punë fizike tej normave normale, e cila ka patur edhe pasoja shëndetësore për të.

Më datë 19.09.2019, ankuesi është vënë në dijeni të një propozimi të bërë nga ana e E. B., për dhënien e masës disiplinore ndaj tij. Në këto kushte, me anë të e-mailit datë 19.09.2019, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, duke kundërshtuar propozimin për masë disiplinore dhe duke dhënë argumentat përkatës. Pavarësisht kundërshtimit të paraqitur me anë të e-mailit, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, me Vendimin datë 20.09.2019, ka formalizuar masën disiplinore *“Vërejtje me shkrim”* ndaj ankuesit.

Pas largimit nga puna të E. B., në pozicionin e Përgjegjësit të Njesisë Teknike u emërua A. B. Sipas ankuesit, A. B. ka qënë koleg me të dhe në vitin 2017, mes tyre ka patur një debat, ku pretendohet se ankuesi është ofenduar nga ana e tij. Në vijim, sapo A. B. ka marrë detyrën, ankuesi pretendon se i janë hequr të gjitha të drejtat administrative dhe akseset mbi sistemet informatike, duke e detyruar në këtë mënyrë që ai t'i drejtohet kolegëve në hierarki më të ulët, për t'iu referuar sistemeve për të cilat ai duhet t'i kishte nën kontroll. Më pas, pretendon se është kërcënuar nga ana e A. B., për shkak se nuk e ka gjetur në zyrën e punës, pavarësisht faktit që ai ka qënë duke ushtruar detyrën e tij brenda institucionit. Në këto kushte, me anë të e-mailit datë 19.12.2019, i është drejtuar A. B., duke i kërkuar që të ndal diskriminimin ndaj tij dhe ta trajtojë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë me kolegët, pasi pavarësisht mosprezencës së 2 prej tyre në punë, vëmendja i është tërhequr pa të drejtë vetëm ankuesit. Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, ankuesi pretendon se në rrugë verbale i është thënë nga A. B. se: *“...nuk ke punë me të tjerët ti, ne e dimë vetë se si i bëjmë kontrollet”*. Sipas ankuesit, në mënyrë tendencioze nga ana e A. B., i është caktuar një tavolinë fikse pune, vetëm atij në krahasim me kolegët e departamentit, për ta vënë nën kontroll.

Pavarësisht masave mbrojtëse dhe distancës fizike që duhet të mbahej ndërmjet individëve, në kuadër të pandemisë së COVID 19, ankuesi pretendon se është njoftuar nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të IT-së për kryer detyrën pa masa mbrojtëse (maskë). Në vijim, me anë të sms-ve ankuesi ka kërkuar nga ana e A. B., që për të shmangur kontaktin me punonjësit e tjerë, sapo të blejë një maskë mbrojtëse do kryejë detyrën e dhënë, por një veprim i tillë është kundërshtuar, duke e urdhëruar të vijojë punën. Pas rezistencës së ankuesit, A. B. ka njoftuar Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, A. M. Në këto kushte, A. M. ka thirrur ankuesin në zyrë duke i thënë: *“Ne këtu jemi privat dhe ai nuk pyet fare për masat mbrojtëse. Ti je i detyruar të shkosh.”*. Në përgjigje të saj, ankuesi i është drejtuar duke shprehur se ai kujdeset për shëndetin e tij dhe të familjes, prandaj është i detyruar të vendos masa mbrojtëse në momentin që do të ketë kontakt me persona të tjerë. Gjithashtu, i ka sqaruar se, nëse ka ndonjë pakënaqësi me punën e kryer prej tij, t’ia dërgojë me anë të e-mailit. Në këtë moment, A. M. i është përgjigjur duke e kërcënuar me shprehjen: *“kujdes po të them”*.

Pas debatit të zhvilluar me A. M., ankuesi pretendon se ajo u angazhua personalisht për të gjetur shkaqe dhe për ta larguar nga puna. Një nga rastet e pretenduara, sipas ankuesit, ka qënë fakti që ai ka ndihmuar vartësen e A. M., një zonjë në prag të pensionit, për të liruar zyrën dhe për të zhvendosur një kompjuter nga tavolina e saj në një tavolinë tjetër, brenda institucionit. Menjëherë, A. M. dhe A. B., kanë thirrur ankuesin në zyrë dhe sipas tij kanë nisur presionin duke e akuzuar për vjedhje të kompjuterit. Në përgjigje të tyre, ankuesi i ka sqaruar se është thirrur nga punonjësja në fjalë dhe i është kërkuar ta ndihmojë për të zhvendosur një kompjuter. Në kushtet që nga ana e eprorëve ka vijuar presioni dhe pretendimi që ai ka kryer vepër penale, ankuesi i është përgjigjur duke i sqaruar se për këtë akuzë të padrejtë të tyre do ti dretohet organit të Prokurorisë. Në këtë moment, sipas ankuesit A. M. i është drejtuar me një ton kërcënues dhe fyes duke i thënë: *“Diskutimin e vendos unë kur e mbyll...Dil përjashta”*. Në përgjigje të saj ankuesi, i ka sqaruar se zyra e saj është pronë publike dhe toni i përdorur ndaj tij është diskriminues.

Më datë 21.05.2020, ankuesi sqaron se është thirrur nga ana e specialistes së Burimeve Njerëzore, duke e informuar lidhur me dhënien e 2 masave disiplinore ndaj tij në të njëjtën datë, për debatin e zhvilluar me eprorët. Në përmbajtje të tyre, me Vendim datë 21.05.2020, ndaj ankuesit ishte marrë masë administrative me gjobë në vleftën e gjysmës së pagës mujore, me motivacion: *“Për moszbatim të rregullores së brendshme të Sektorit IT, pasi më datë 09.05.2020, nga zyra e Specialistes së Burimeve Njerëzore të Emisioneve Tematike & Lajmeve ka marrë një kompjuter (i cili ka qënë në inventar të Specialistes së Burimeve Njerëzore) dhe e ka transferuar atë në zyrën e Gazetarëve të redaksisë së Lajmeve Radio të Njesisë së Emisioneve Tematike (duke e zëvendësuar atë me një kompjuter tjetër i cili nuk është në inventarin e asnjë punonjësi të RTSH-së), veprim i cili çënon rëndë pronën e RTSH-së”*. Me vendimin Nr. 321, datë 21.05.2020, lidhur me motivacionin e masës administrative me gjobë, i është dhënë edhe masa disiplinore *“Vërejtje me shkrim për paralajmërim për përjashtim nga puna”*.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të kryera drejtuesit e RTSH-së, kanë si synim përfundimtar largimin e tij nga puna, për shkak të bindjeve të kundërta politike me Drejtorin e Përgjithshëm të RTSH-së, si dhe për shkak të kundërshtimit të tyre në zbatimin e Urdhërit Nr. 75/11 prot., datë 21.12.2018.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit në marrëdhëniet e punës, anulimin e masave disiplinore të dhëna ndaj tij dhe ndërprerjen e situatës diskriminuese.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”³.*

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

³ Për shkak të kundërshtimit të tyre në zbatimin e Urdhërit Nr. 75/11 prot., datë 21.12.2018

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Me anë të shkresës Nr. 762 prot., datë 06.11.2019, Komisioneri i është drejtuar Radio Televizionit Shqiptar dhe ka kërkuar informacion, si dhe parashtrime rreth pretendimeve të ngritura nga ana e B. M.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, RTSH, me anë të shkresës⁵ Nr. 1791/3 datë 01.07.2020 informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke sqaruar ndër të tjera se: *“...Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga B. M., për problematikat e trajtuara nga ai si kryetar i grupit të punës për dorëzimin e mallrave të Kontratës ‘Blerje licence për përdorues në sistemin Mam, Etere, Payout si dhe Suport (MNSH)’, ju kërkuam një informacion i detajuar Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Prokurimeve, material i cili është bashkëngjitur kësaj shkrese. Në informacionin e dorëzuar nga Drejtori i Planifikimit dhe Prokurimeve, shprehet qartë që sugjerimet e B. M., jo vetëm që kanë vlejtur dhe i janë paraqitur kompanisë fituese si kërkesë për ndryshim, por gjithashtu është rishikuar grupi i punës, duke u ndryshuar dhe duke u shtuar edhe 3 punonjës të tjerë të specializuar të fushës (Përgjegjësi i Sektorit të IT u vendos si kryetar i këtij grupi, si dhe u zëvendësua njëri prej anëtarëve të grupit, punonjësi A. J., në detyrën me emërtesë Specialist IT, i cili në atë periudhë ndodhej me leje vjetore).*

Theksojmë se B. M. në mënyrë të përsëritur, është thirrur në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe është këshilluar herë pas here, si dhe i është tërhequr vëmendja për mosbashkëpunim në ambjentet e punës gjatë orarit të punës (në të gjitha rastet kur ky shqetësim është bërë prezent pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore). Informojmë se ka patur raste kur prezenca e tij për asistencë teknike ishte e nevojshme në një zyrë dhe ai nuk paraqitej, duke sjellë pretendime nga më të ndryshmet, ndërkohë kur në vend të tij thërriteshin kolegët e tjerë të Sektorit të IT, të cilët jo vetëm ishin korrekt në komunikim dhe të përpiktë, por edhe përfundonin atë punë për të cilën B. M. thoshte se nuk realizohej dotë.

B. M. gjithashtu i është tërhequr vëmendja për komunikimin tendencioz dhe aspak mirëkuptues në të gjitha situatat që krijoheshin prej tij në këtë sektor (si në rastet e mos zbatimit të detyrave të caktuara nga eprori i sektorit të tij). Ky problem me B. M. ka ekzistuar, si në kohën kur Përgjegjës i Sektorit të IT ka qënë A. K. (deri në fund të vitit 2019), e më pas në periudhën kur Përgjegjës i Sektorit ka qënë E. B. (deri në Janar të vitit 2020), si dhe pas Janarit 2020 e në vazhdim ku Përgjegjës i Sektorit të IT-së është A. B. Të gjitha këto janë të pasqyruara dhe në Vlerësimin Vjetor të Punës për B. M., një kopje të të cilave do t’i gjeni bashkëngjitur kësaj shkrese.

B. M. (mqe e ka përmendur në ankesë) duhet të ketë prova shumë të forta shkrese, të cilat vërtetojnë që punësimi i E. B., është bërë me synimin e vetëm për të larguar atë nga puna...

Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni një informacion të detajuar të Përgjegjësit aktual të Sektorit të IT, A. B., i cili shpjegon hollësisht problematikat e krijuara nga B. M. gjatë periudhës që ai drejton këtë Sektor...”

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 891 prot., datë 02.07.2020

Lidhur me masat disiplinore ndaj B. M., RTSH ndër të tjera sqaron se: “...Në lidhje me masën disiplinore ‘Vërejtje për paralajmërim për pushim nga puna për B. M.’, sqarojmë se, në datën 11.05.2020 u konstatua se kompjuteri i ri, në zyrën e Specialistes së Burimeve Njerëzore (e cila kishte dalë në pension pleqërie në datën 31.03.2020) ishte zëvendësuar me një kompjuter tjetër (me parametra shumë të vjetër) i cili nuk ishte pjesë e inventarit të RTSH. Kompjuteri i ri u vendos dhe u instalua (nga ana e B. M., gjë të cilën e vërtetojnë punonjësi që ishte prezent në zyrë në atë moment) në zyrën e Informacionit Lajme Radio, në tavolinën e punës së vajzës së ish Specialistes së Burimeve Njerëzore. Nga monitorimi i kamerave të sigurisë u konstatua se B. M., më datë 09.05.2020 (ditë e pushimit të tij- e shtunë) së bashku me ish punonjësen e Burimeve Njerëzore (e cila kishte 1 muaj që kishte dalë në pension dhe nuk paraqitej në institucion edhe pse ishte thirrur disa herë për të bërë dorëzimet përkatëse) kishin lëvizur kompjuterat pa vënë në dijeni Përgjegjësin e Sektorit të IT, si dhe pa dijeninë dhe miratimin e Drejtores së Burimeve Njerëzore të RTSH, e cila e kishte në ngarkim këtë kompjuter në kohën kur ishte punonjëse e institucionit tonë. Si pasojë e ngjarjes së ndodhur, punonjësi B. M. në datën 13.05.2020 është thirrur në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në prani të Përgjegjës të Sektorit të IT dhe Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore, është dëgjuar dhe ka dhënë shpjegimet e tij në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 09.05.2020. B. M. tha që ‘i ra rruga në institucion dhe ka ndihmuar një grua të moshuar’ (ndërkohë që në një ditë normale pune, kur B. M. thirrej për të dhënë ndihmën e tij në rastet kur kjo ishte e nevojshme, nuk paraqitej duke u justifikuar që ne duhet të komunikim më parë me shefin e tij, për detyrën që duhet të kryente). Punonjësit i është tërhequr vëmendja për veprimin e bërë, duke i bërë me dije që kjo gjë përbën shkelje të rëndë, pasi ka lëvizur pa dijeninë e personave përgjegjës materiale që janë pronë e RTSH dhe në inventar të RTSH, duke i trajtuar si të ishin pronë private. B. M. me një ton aspak etik dhe duke qeshur vazhdimisht (në një mënyrë që provokonte situatën në të cilën zhvillohej biseda) tha se ‘mund të merrni çdo masë që doni, biles jam në pritje që të shikoj se çfarë do bëni ju, që të veproj...’. Si pasojë e ngjarjes së ndodhur, si dhe bazuar në propozimin e Drejtuesit të Njesisë Teknike, B. M. i është dhënë masa disiplinore ‘Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna’. Për rastin në fjalë, nuk ka masa disiplinore për punonjës të tjerë, pasi B. M. ka vepruar vetëm, duke qënë i shoqëruar nga ish punonjësja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila kishte 1 muaj që kishte dalë në pension.

Bazuar në Nenin 122 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, theksojmë se pretendimi i ngritur nga ana e B. M. për marrjen e ‘Gjobës’ nuk qëndron, pasi ky Vendim është anuluar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH në datën 22.05.2020 (Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të anulimit të këtij Vendimi, si dhe borderon e muajit Maj 2020, e cila vërteton që pagesa mujore ka qënë e rregullt pa asnjë ndalesë. B. M. u vu menjëherë në dijeni të anulimit të këtij Vendimi”).

Sa i përket informacionit të kërkuar nga KMD, nëse ka patur raste të tjera kur janë marrë masa disiplinore ndaj punonjësve të tjerë pjesë e Sektorit të IT, RTSH sqarojë se gjatë 2 vitve (2019-2020) të fundit nuk ka patur raste të tilla.

Në përfundim të shkresës së sipërcituar, RTSH hedh poshtë pretendimin e ngritur nga ankuesi për diskriminimin e tij për shkaqet e cituara në ankesë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

a) Lidhur me masën disiplinore të marrë ndaj ankuesit.

Me Urdhër Nr. 75/11 prot., datë 21.12.2018 “Për krijimin e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallrave të kontratës ‘Blerje licencë për përdorues në sistemin Mam Etere dhe Playout, si dhe Suport (MNSH)’”, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, ka caktuar ankuesin së bashku me 2 kolegë të tij, për marrjen në dorëzim dhe ndjekjen e kontratës në fjalë. Pasi është vënë në dijeni të Urdhërit të sipërcituar ka hartuar një procesverbal, drejtuar Drejtorit të Planifikimit dhe Prokurimeve, në të cilin evidentohet se ankuesi dhe 2 anëtarët e tjerë të Komisionit për marrjen e mallit në dorëzim, kanë verifikuar dhe kanë kërkuar plotësimin e 2 pikave në mënyrë që të zbatohet urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

Me shkresën Nr. 75/14 prot., datë 22.01.2019, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, i është drejtuar Shoqërisë fituese të prokurimit, duke i kërkuar plotësimin e mangësive të evidentuara nga Komisioni i Verifikimit dhe Marrjes në Dorëzim të Kontratës Nr. 75/9 prot., datë 17.12.2018.

Referuar shkresës Nr. 58/1 prot., datë 28.12.2019, konstatohet se pas përgjigjes së marrë nga Shoqëria fituese, është organizuar një takim mes përfaqësuesve të saj dhe të RTSH-së (Drejtuesi i Njësisë Teknike, Përgjegjësi i Sektorit IT, anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim (me përjashtim të anëtarit A. J., për shkak se ishte me leje vjetore), Drejtori dhe një specialist i Drejtorisë së Planifikimit dhe Prokurimeve), të cilët kanë konstatuar se pretendimet e paraqitura nga ana e komisionit të marrjes në dorëzim nuk qëndronin. Gjithashtu, në këtë shkresë citohet se vetëm një nga anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, *B. M. i qëndronte akoma idesë së paraqitur në procesverbalin përkatës*. Në vijim, është vendosur që procedura e marrjes në dorëzim duhej realizuar dhe të shtohet numri i anëtarëve të komisionit nga 3 në 5 anëtarë, duke parë mundësinë e përfshirjes së punonjësve të cilët kishin bërë specifikimet teknike të prokurimit, si dhe zëvendësimi i një anëtari i cili ndodhej me leje të zakonshme.

Me Urdhër Nr. 75/17 prot., datë 30.01.2019 “Për krijimin e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallrave të kontratës ‘Blerje licencë për përdorues në sistemin Mam Etere dhe Payout, si dhe Suport (MNSH)’”, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, ka caktuar komisionin e ri të marrjes në dorëzim, duke bërë që nga 3 anëtarë komisioni të përbëhej nga 5 anëtarë, si dhe duke bërë pjesë të tij, në cilësinë e Kryetarit, Përgjegjës të Sektorit të IT. Ankuesi dhe një specialist, të cilët ishin pjesë e komisionit të mëparshëm, nuk ndryshuan, ndërsa u shtuan edhe 2 anëtarë të tjerë.

Në vijim, referuar Procesverbalit Nr. 75/18 prot., datë 01.02.2019, pas verifikimeve të nevojshme, komisioni, ku veç ankuesit i cili në fund të këtij dokumenti ka bërë sërish objeksionet e tij lidhur me 1 nga pikat e kontratës me Shoqërinë fituese të Prokurimit, të gjithë anëtarët e tjerë kanë rënë dakord me marrjen në dorëzim të mallrave të kontratës “Blerje licencë për përdorues në sistemin Mam Etere dhe Payout, si dhe Suport (MNSH)”.

Më datë 19.09.2019, një punonjëse e RTSH-së, L. R., i është drejtuar me e-mail Përgjegjës të IT-së, shtetasit E. B., me anë të të cilit e bën me dije se, nga ana e specialistëve të IT-së, i është ndërruar kompjuteri dhe nuk i është ruajtur asnjë nga informacionet që kishte patur në arkivën e kompjuterit të mëparshëm. Sipas saj, paraprakisht i kishte kërkuar specialistit të IT-së, të mos i fshihej asnjë nga materialet, por rezultoi që asnjë prej tyre nuk ishte ruajtur.

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar rezultoi se, Përgjegjësi i IT-së, i ka kërkuar ndjesë punonjësës L. R. dhe e ka siguruar atë që të gjitha materialet e humbura do të rikuperohen. Gjithashtu, ka kërkuar nga ana e saj të evidentojë specialistin i cili ka bërë këtë veprim në mënyrë që të merren masat përkatëse. Nga ana e shtetasës L. R., i është bërë me dije se specialisti i cili kishte bërë ndërrimin e kompjuterit ishte punonjësi B. M.

Për situatën e ndodhur, sipas informacionit⁶ të paraqitur nga ana e Përgjegjës aktual të Sektorit të IT-së, shtetasit A. B., (duke qënë se Përgjegjësi i IT-së, në atë kohë, shtetasi E. B., ishte larguar nga puna), Përgjegjësi i Sektorit të IT-së në atë kohë, e ka thirrur ankuesin në një mbledhje sektori dhe i ka dhënë mundësinë të jepte argumentat përkatës, por nga ana e tij është arsyetuar se ruajtjen e informacionit duhet ta kishte bërë kolegu i turnit të dytë. Kur është pyetur se për cilin kolegj bëhej fjalë, ankuesi nuk kishte dhënë asnjë informacion duke thënë “Asnjë”.

Në nenin 26, të Statutit të RTSH-së, parashikohet se: “Drejtuuesi i Njesisë Teknike:

a) organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e njesisë;

b).....

c).....

ll) propozon te Drejtori i Përgjithshëm emërimin dhe lirimin nga detyra të punonjësve në varësi të tij, duke përfshirë këtu edhe ata me kontrata pune me kohë të pjesshme;”

⁶ Me anë të shkresës Nr. 1791/2 prot., datë 25.06.2020, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, lidhur me rastin e B. M.

Mbështetur në Rregulloren e Brendshme të Sektorit të IT-së, në pikën 2, të saj, parashikohet se: *“Specialisti IT i T-rë përgjigjet para përgjegjësit të sektorit IT dhe ka këto detyra: 2.1 I raporton në çdo kohë informacion të hollësishëm përgjegjësit të sektorit IT lidhur me ecurinë e detyrave dhe masave konkrete që janë marrë për realizimin e tyre...”*

Në këtë kuadër, Përgjegjësi i IT-së me anë të shkresës datë 19.09.2019, i është drejtuar Drejtuesit të Njesisë Teknike, duke i sqaruar problematikën e ndodhur, si dhe duke propozuar që ndaj specialistit B. M., të merrej masa disiplinore përkatëse sipas parashikimeve të Kodit të Punës, për mungesë profesionalizmi dhe mosvënie në dijeni të problemit të shkaktuar.

Referuar shkresës Nr. 1791/2 prot., datë 25.06.2020, të Përgjegjësit aktual të Sektorit të IT-së, shtetasit A. B., rasti i mësipërm, ishte i përsëritur nga ana e B. M., pasi përpara 2 vitesh të njëjtin veprim e ka kryer sërish ndaj punonjësës L. R., duke i formatuar kompjuterin dhe fshirë të gjithë arkivën, pa vënë në dijeni përgjegjësit e Sektorit apo eprorët e tij për problemin e ndodhur.

Me shkresën Nr. 619 prot., datë 19.09.2019, Drejtuesi i Njesisë Teknike, për arsyet e mësipërme i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, duke i propozuar që ndaj B. M. të merrej masë administrative. Në këto kushte, me Vendim datë 20.09.2019, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, ka vendosur masën disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*, ndaj ankuesit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e RTSH-së, ankuesi nuk ka kundërshtuar në rrugë administrative masën disiplinore, por në shkresën me anë të së cilës i është përcjellë ka nënshkruar se nuk është dakord me të.

Përsa më sipër, masa disiplinore e marrë ndaj ankuesit është iniciuar mbështetur në ankesën e paraqitur nga ana e punonjësës L. R., ku realisht është evidentuar se ka patur një problematikë të ndodhur gjatë kryerjes së detyrave nga ana e ankuesit. Pra, në këtë kuptim, nuk provohet fakti se nisja e procedimit disiplinor ndaj tij ka ardhur drejtpërdrejtë si propozim nga Përgjegjësi i Sektorit, pa shkaqe të arsyeshme.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se pavarësisht pretendimit të ankuesit se është trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe të pabarabartë për shkak të kundërshtimit të marrjes në dorëzim të kontratës së prokurimit të sipërcituar, evidentohet që marrja e masës disiplinore ndaj tij, është e mbështetur ligjërisht dhe nuk evidentohet se kemi një trajtim të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së.

Gjithashtu evidentohet se, ndaj 2 kolegëve të ankuesit, të të njëjtit sektor, pavarësisht kundërshtimit të marrjes në dorëzim të kontratës së prokurimit, ndaj tyre nuk është propozuar, si dhe nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Madje, gjatë procedurës hetimore, Komisioneri evidentoi se është larguar nga detyra Kryetari i Grupit të Punës për marrjen në dorëzim të mallrave të kontratës, i cili mbante edhe detyrën e eprorit direkt të

ankuesit, atë të Përgjegjësit të Sektorit të IT-së. Pra, nuk evidentohet se vërejtja e dhënë ndaj ankuesit të ketë lidhje të drejtëpërdrejtë me kundështimit të marrjes në dorëzim të kontratës së prokurimit.

b) Lidhur me masën e detyrë disiplinore të marrë ndaj ankuesit

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, pas largimit nga puna të E. B., në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të IT-së është emëruar A. B.

Referuar e-maileve të shkëmbyera, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së, A. B., më datë 18.12.2019, është paraqitur në zyrën e ankuesit dhe duke qënë se nuk e ka gjetur aty, i ka dërguar e-mail nëpërmjet të cilit i thotë: *“besmir, erdha në zyrë dhe stë gjeta në orën 12:30. Më njofto nëse lëviz nga vendi i punës. Tani ngjitu tek zyra dhe vazhdo me montimin e kompjuterave...”*. Të nesërmen më datë 19.12.2019, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së, i dërgon sërish e-mail ankuesit ku i kujton se gjatë detyrës së ushtruar ka harruar të kryej një prej tyre dhe në fund të e-mailit i lutet të tregohet më i kujdëshëm.

Më pas, në të njëjtën ditë, ndërmjet tyre janë shkëmbyer e-maile nëpërmjet së cilave, Përgjegjësi i Sektorit i kërkon ankuesit edhe një herë të kryejë detyrën e lënë sipas këshillave të dhëna prej tij. Në përgjigje të tij, më datë 19.12.2019, ankuesi i është drejtuar sërish me e-mail ku i ka sqaruar ndër të tjera se: *“...Kjo gjuhë komunikimi, tregon qartë dëshirën tuaj për të gjetur tek unë shkelje që nuk ekzistojnë, kjo për arye të konflikteve dhe mosmarrëveshjeve që ne kemi pasur në të kaluarën, kur kemi qënë në marrëdhënie thjeshtë kolegë-kolegë. Me emërimin tuaj në detyrë, pa mbushur muajin në këtë detyrë keni kryer një sërë sulmesh ndaj meje, të cilat çënojnë 2 pika të Kodit të Punës: 1. Mosrespektimin e dinjitetit të të punësuarit dhe sjellje tendencioze ndaj tij; 2. Diskriminim në vendin e punës duke kryer kontrole, presione, diskriminime dhe qortime të pa qëna të cilat më bëjnë të ndihem në presion në vendin e punës; 3. Mosaplikimi i standartit të barazisë në staf. Të gjitha shkeljet e mësipërme mundem ti provoj me materialet e nevojshme, gjithashtu dhe shkelje të tjera të cilat nuk janë objekt i këtij emaili. Gjithashtu, email tjetër i cili specifikon pozicion pune për 3 pjestarë të stafit, në një zyrë e cila është jashtë standardeve të përcaktuara në Kodin e Punës për nivelin e zhurmës, lagështirës etj, dhe për pjesën tjetër të stafit nuk përcakton të njëjtën gjë, duket qartazi që ju e bëni këtë gjë që të më vini objekt kontrolli vetëm mua dhe jo personat e tjerë. Është një fakt më shumë i cili përforcon diskriminimin në punë. Në komunikimin verbal që bëme dje, pas dyshimeve që ju kishit që unë isha larguar nga institucioni, ju kërkova që në mënyrë urgjente të bënim verifikimet dhe të bënim një listëprezencë të stafit, ashtu si ligji e kërkon. Një listëprezencë kolektive e certifikuar nga Burimet Njerëzore, por ju në mënyrë të prerë dhe arrogante më thatë se si drejtues njësie e përcakton vetë kë kontrollon dhe kë jo në vendin e punës dhe nuk pranoje të bënim kontroll kolektiv mbi stafin, kjo për arsye të cilat nuk janë objekt i këtij emaili, por do të sqarohen në një stad të mëtejshëm. Unë në 6 vite në institucion gjithnjë kam kryer detyrat e mia me përgjegjshmëri dhe do vazhdoj ti bëj për një kohë të gjatë, nuk kam shkelur asnjëherë asnjë nen*

ose ligj, apo urdhër eprori. Propozoj për ju që të ktheheni në komunikim dhe marrëdhënie institucionale dhe jo tendencioze si janë në këto momente. Në të kundërt kjo gjë është e dëmshme për punën dhe ne.”

Në vijim të komunikimeve, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së i ka dërguar e-mail më datë 19.12.2019, ankuesit dhe dy kolegëve të tij, duke i sqaruar se: *“Me kërkesë të B. M., po ju dërgoj vendqëndrimin në punë. Deri në momentin që do marrim një zyrë tjetër, vendqëndrimet në punë do të jenë si më poshtë: A. J., Zyra e IT në Televizion, tavolina në krahun e djathtë kur hyn në zyrë; B. M., Zyra e IT në Televizion, tavolina në krahun e majtë kur hyn në zyrë dhe E. B., Zyra e IT në Televizion, tavolina përballë kur hyn në zyrë. (renditja e emrave është bërë sipas rendit alfabetik të shënkronjës së parë të emrit dhe jo preferenciale). Kolegët e tjerë që për momentin nuk kanë zyrë, të qëndrojnë në pritje.”*

Në vijim, referuar akteve të vëna në dispozicion nga ana e palëve, në datën 11.05.2020, nga ana e drejtuesve të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ishte konstatuar një kompjuter i ri, në zyrën e Specialistes së Burimeve Njerëzore, e cila kishte dalë në pension pleqërie (sipas informacionit të vënë në dispozicion, në datën 31.03.2020) ishte zëvendësuar me një kompjuter tjetër i cili nuk ishte pjesë e inventarit të RTSH-së.

Pasi ishte konstatuar zëvendësimi i këtij kompjuteri, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së me anë të një shkrese (e cila nuk mban datë), i është drejtuar Drejtorit të Njësisë Teknike duke e informuar lidhur me këtë situatë. Ndër të tjera, i ka sqaruar se referuar pamjeve filmike të institucionit, ishte konstatuar se këtë veprim e kishte kryer Specialisti B. M., pa vënë në dijeni dhe pa marrë miratimin nga asnjë nga eprorët e tij. Në këto kushte, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së, kishte propozuar dhënien e një mase disiplinore ndaj ankuesit.

Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, në Nenin 37, parashikon se: *“Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore. Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm.”*

Në vijim, referuar Proceverbalit të mbajtur më datë 13.05.2020, ankuesi është thirrur për të sqaruar situatën e ndodhur, në prani të Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësit të Sektorit të IT-së. Referuar këtij procesverballi, ankuesi është shprehur në lidhje me këtë situatë, ndër të tjera se: *“...ka kryer veprimin pa dijeninë e Përgjegjësit të Sektorit të tij, si dhe pa njoftuar Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, duke u justifikuar se po ndihmonte një ish punonjëse të moshuar”*. Gjithashtu, nga ana e Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore, i është thënë ankuesit se ditën që janë ndërruar kompjuterat ankuesi nuk duhet të ishte në punë, pasi ishte ditë pushimi për të. Në përgjigje të saj, B. M. ka pranuar se është paraqitur në institucion për arsye personale dhe jo pune. Në përmbajtje të Procesverbalit, evidentohet se ankuesi është bërë me dije

nga ana e punëdhënësit, për ngjarjen e ndodhur do t'i përcillet relacioni përkatës Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, i cili do të bënte shënimet e rastit. Në përfundim, konstatohet se ai është firmosur nga ana e Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore, Përgjegjës të Sektorit të IT-së, ndërsa për ankuesin është vendosur shënimi: “...nuk pranoi të firmoste duke thënë ‘bëni çfarë të doni’”.

Më pas, me shkresën Nr. 241 prot., datë 18.05.2020, Drejtuesi i Njesisë Teknike, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së duke i propozuar të merren masa sipas Kodit të Punës dhe kontratës individuale ndaj B. M., për shkak se situata e ndodhur përbën një shkelje të rëndë.

Me Vendim Nr. 321, datë 21.05.2020, protokolluar me Nr. 1442/1 prot., Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së Vendosi: “B. M., në detyrën me emërtesë ‘Specialist IT i parë’ në Sektorin IT, në Njësinë Teknike të RTSH-së, mbështetur në nenin 11, pika 4, germa d, të Kontratës Individuale të Punës, ti jepet masë disiplinore: ‘Vërejtje me shkrim për paralajmërim për pushim nga puna’, me motivacionin: ‘Për veprime të rënda në punë, në vendin e punës jashtë orarit të punës, të paautorizuar nga eprori i tij dhe pa njoftuar atë më parë për lëvizjen e pajisjeve të cilat janë pronë e RTSh, si dhe moszbatim të Rregullores së brendshme të sektorit të IT (si dhe detyrave që ai ka në ngarkim), pasi në datën 09.05.2020, nga zyra e Specialistes së Burimeve Njerëzore të Njesisë së Emisioneve & Lajmeve ka marrë një kompjuter (i cili ka qënë në inventar të Specialistes së Burimeve Njerëzore) dhe e ka transferuar atë në zyrën e Gazetarëve të redaksisë së Lajmeve Radio të Njesisë së Emisioneve Tematike (duke e zëvendësuar me një kompjuter tjetër, i cili nuk është në inventarin e asnjë punonjësi të RTSH-së)”.

Gjithashtu, me Vendim Nr. 1474 prot., datë 21.05.2020, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së Vendosi: “B. M., në detyrën me emërtesë ‘Specialist IT i parë’ në Sektorin IT, në Njësinë Teknike të RTSH-së, mbështetur në nenin 11, pika 4, germa d, të Kontratës Individuale të Punës, ti jepet masë administrative me ‘Gjobë’ në vleftën e gjysmës së pagës mujore, me motivacion: Për moszbatim të rregullores së brendshme të sektorit të IT, pasi më datë 09.05.2020, nga zyra e Specialistes së Burimeve Njerëzore të Njesisë së Emisioneve & Lajmeve ka marrë një kompjuter (i cili ka qënë në inventar të Specialistes së Burimeve Njerëzore) dhe e ka transferuar atë në zyrën e Gazetarëve të redaksisë së Lajmeve Radio të Njesisë së Emisioneve Tematike (duke e zëvendësuar me një kompjuter tjetër, i cili nuk është në inventarin e asnjë punonjësi të RTSH-së), veprim i cili cënon rëndë pronën e RTSH-së”.

Referuar Procesverbalit të datës 21.05.2020, të mbajtur nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, konstatohet se në të njëjtën datë, ankuesit i janë bërë me dije dy masat e marra nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe ai i ka refuzuar.

Më datë 22.05.2020, me Vendimin Nr. 22.05.2020, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH, Vendosi anulimin e Vendimit të datës 21.05.2020, me objekt “Gjobë”, për ankuesin.

Neni 203, i Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon në pikën 1, se: “...Afati i parashkrimit për masën disiplinore është një vit, nga momenti i marrjes së masës disiplinore, njoftuar me shkrim punëmarrësit.”

Nga analiza e sipërcituar dhe informacioni i vënë në dispozicion nga ana palët, konstatohet se RTSH, përveç faktit që situata e ndodhur më datë 09.05.2020 cënonte rëndë pronën e RTSH-së, ka përdorur si argument apo si masë rënduese edhe masën disiplinore⁷ të datës 20.09.2019. Në këtë kuptim dhe referuar provave të administruara, Komisioneri e gjen të mbështetur ligjërisht këtë veprim të RTSH-së kundrejt ankuesit.

Gjithashtu, evidentohet se masa disiplinore e marrë ndaj ankuesit është mbështetur në situatën e ndodhur, gjatë së cilës ai pavarësisht parashikimeve në Rregulloren e Brendshme të RTSH-së, nuk ka marrë miratimin dhe nuk ka vënë në dijeni për asnjë moment eprorët e tij lidhur me transferimin e kompjuterave nga një zyrë në tjetrën. Pra, duke kryer kështu në veprim që bie ndesh me parashikimet e Kontratës Individuale të Punës dhe Rregullores së Brendshme të RTSH-së.

Pavarësisht e-mailit të dërguar ndaj eprorit të tij më datë 19.12.2019, për të ndalur situatën diskriminuese, ai ka marrë një përgjigje duke trajtuar ankuesin së bashku me dy kolegët e tij në mënyrë të barabartë dhe duke i vendosur ata në një zyrë, duke i caktuar vendet e punës, si dhe duke lënë kolegët e tjerë pa një vend pune.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është ekspozuar përpara një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së.

c) Lidhur me pretendimin se ankuesi është urdhëruar të ushtrojë funksionin pa maskë mbrojtëse.

Sipas informacionit të administruar nga palët⁸, me anë të mesazheve telefonike të shkëmbyera ndërmjet ankuesit dhe Përgjegjës të Sektorit të IT-së, rezulton që në dy raste ankuesi është ngarkuar për të ushtruar detyrën brenda institucionit nga Përgjegjësi i tij, por nuk ka pranuar ta realizojë deri në momentin që do të pajisej me maskë mbrojtëse.

Në vijim nga ana e Përgjegjës të Sektorit ankuesit i është thënë se duhet ta kishte siguruar maskën përpara se të paraqitje në punë dhe të mos e linte për atë moment. Megjithatë, nga përmbajtja e mesazheve nuk konstatohet se ankuesi është detyruar apo urdhëruar të ushtrojë detyrën pa maskë mbrojtëse.

⁷ Vendim datë 20.09.2019, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, ka vendosur masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”, ndaj ankuesit

⁸ Mesazhe telefonike të shkëmbyera ndërmjet ankuesit dhe Përgjegjës të Sektorit të IT-së, më datë 31.03.2020.

Gjithashtu, referuar e-maileve⁹ të shkëmbyera mes drejtuesve të RTSH-së, të vëna në dispozicion në cilësinë e provës, të gjithë punonjësit deri në momentin që do të sigurohen maskat nga RTSH-së, do të duhet t'i sigurojnë vetë dhe brenda pak ditëve do të rimburohen në masën 2000 lekë.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është ekspozuar përpara një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së.

d) Lidhur me komunikimin e ankuesit me Përgjegjësin e Sektorit të IT

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga palët, më datë 01.07.2020 ankuesi i është drejtuar me e-mail Përgjegjësit të Sektorit të IT, duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...Sipas kërkesës suaj, mbërrita në magazinë dhe magazinierri më kërkoi që maskat të bëheshin të gjitha dalje në emrin tim, pas kundërshtimit nga ana ime për shkak se duhet të kemi shpërndarje proporcionale të maskave, zonja komunikoi me ju në telefon dhe ju i komunikuat t’iu sillja një përgjigje me email. Duke marrë shkas nga situata emergjente nuk mund të lija kolegët pa mjete mbrojtëse, për këtë arsye maskat i mora unë dalje nga magazina, por bashkë me to mora dhe 8 kopje fature dalje të cilat kolegët do ti gjejnë në zyrën poshtë për ti firmopsur së bashku me maskat, që të ndara na takojnë rreth 22 copë për punonjës. Mirëpres kolegët në Zyrën IT, Kati I në TV, në fund të ditës do ju dërgoj me email kopjet e faturave të firmosura. Me jetë të gjatë dhe prosperitet...”*

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, më datë 02.07.2020, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së, i sqaron ankuesit ndër të tjera se: *“...uroj jetë të gjatë dhe prosperitet për ju edhe familjen tuaj gjithashtu. Nuk më duket një urim i përshtatshëm në një ambient pune, por ndoshta marrja e kartës së anëtarësisë të Partisë Demokratike me sa shoh ju ka ndryshuar në shumë aspekte përfshirë edhe mënyrën si ju përshëndetni dhe ka përforcuar tek ju gjetjen e çdo arsyeje për të zvarritur punët që të ngarkohen dhe për të hapur debat. Për sa i përket marrjes në dorëzim të maskave nuk e kuptoj pse i more të gjitha sepse në telefon mua me the që nuk firmos, duke dhënë arsye se të gjithë duhet të firmosin. Ndërkohë që në muajt paraardhës kolegët e tu kanë firmosur për të gjitha materialet dhe nuk ju kanë kërkuar ju të hidhni firmë për pjesën tuaj. Shtoj këtu se maskat janë mall konsumi dhe jo mall inventari dhe ti nuk punon magazinier pasi nuk ke as shkollimin e duhur për këtë. Për sa i përket faktit se ti nuk i ke dhënë S. pjesën e maskave që më takojnë mua, po të kujtoj se S. nuk përgjigjet para teje por përpara meje. Kështu që të lutem të gjitha materialet që more silli sipër tek zyra IT në RTSH dhe lexo edhe një herë rregulloren e Sektorit IT që kam dërguar para disa ditësh. ”*

Ndërkohë në po të njëjtën ditë ankuesi i është përgjigjur eprorit të tij, Përgjegjësit të Sektorit të IT, me e-mail, duke i sqaruar se: *“Po lëviz në drejtim të marketit për të marrë ujë për të pirë, tashmë jam në zyre dhe po ju kthej përgjigje për emailin e dërguar nga ana juaj, ndërkohë*

⁹ E-maile datë 26.03.2020 dhe 16.03.2020

maskat janë tek zyra jonë, nëse ke nevojë urgjente për to mund ti marrësh në zyrën poshtë. Unë nuk jam kamarier maskash, por specialist IT. Gjithsesi detaje do ju dërgoj në emailin përgjigje.”

Në përgjigje të ankuesit, Përgjegjësi i Sektorit të IT, i drejtohet me e-mail duke i thënë se: *“Për ujë ke makinatat në katin e dytë, por gjithsesi nëse lëviz nga vendi i punës më lajmëro përpara se të levizësh. Të lutem tregohu pak më i kujdesshëm e gjuhën e përdorur në komunikim dhe sill maskat tek koleget tek zyra ne RTSH si ata u bënë "kamarierë" dhe ti sollën ty në zyrë materialet çdo muaj, për muajt e shkuar.”*

Në vijim me anë të e-mailit ankuesi i drejtohet sërish eprorit të tij duke analizuar e-mailet e sipërcituara dhe duke i sqaruar se: *“...Ju bëj me dije se urimi i përdorur nga ana ime është një nga urimet standarte që përdoret në emaile në botën jashtë, këtë mund ta vërtetoni në google, me bën përshtypje fakti që ju ndërkohë që nuk ju pëlqen urimi jo vetëm po e përdorni me mua, por vendos në të dhe familjen time. Në fakt është hera e dytë që e përmend familjen time, hera e parë ishte kur më keni ofenduar në zyre në sy të kolegëve. Nuk me duket normale për ju si titullarë të mereni me familjarët e kolegëve....Ju vë në dijeni se bindjet e mia politike janë personale dhe ju nuk mund të më gjykoni mua mbi to. Gjithashtu me surprizon fakti që ju edhe pse i dypunësuar dhe tek Media Private Neës 24 (Gjë e cila është në shkellje të plotë të pikës së kontratës së punës në të cilën nuk lejohet ti bëhet konkurrencë RTSH duke punuar në media të tjera) keni kohë dhe mereni me detaje që nuk i përkasin punës... Po nuk doja të firmos marjen në dorëzim të maskave për gjithë kolegët, por ndërrova mendje dhe e bëra këtë gjë për të përshpejtuar procesin e shpërndarjes së maskave, dhe me faturat doja të kisha provat materiale, ku koleget mos të kishim më dyshime se maskat janë tërhequr nga ata, dhe mos të perseritej fenomeni rradhës kaluar ku disa kolegë nuk i moren të gjitha maskat, po është e vërtetë që nuk më kanë kërkuar firmë për rradhën e kaluar, por unë do kisha vullnetin tim për të firmosur për maskat e mara në përdorim nga ana ime...Kolegu S. u paraqit dje në zyrën poshtë dhe në asnjë moment nuk kërkoj maskat në emrin tënd, gjithsesi për këtë fenomen komunikova me kolegun S. dhe do konsultohem me të, dhe do presim një email nga ana e tij. Ju bëj me dije se ne kemi një kontratë pune kolektive në RTSH dhe detyra ime është specialist IT, gjë e cila nuk parashikon të bëj shpërndarësin e maskave, kjo është një detyrë e cila nuk është e përmendur në kontratë.”*

Gjithashtu me anë të e-maileve të shkëmbyera më datë 10.06.2020, evidentohet se ankuesi ngarkohet me një detyrë nga ana Përgjegjësit të Sektorit të IT-së. Pas përfundimit të detyrës, ankuesi i dërgon e-mail duke i sqaruar eprorit të tij që e ka përfunduar detyrën dhe e lajmëron lidhur me datat në të cilat do të kryejë lejen e zakonshme.

Në vijim, Përgjegjësi i Sektorit të IT, i shkruan sërish e-mail ankuesit duke i kërkuar që të përfundojë detyrën e dhënë e më pas ti shkruaj sapo ta ketë përfunduar. Duke mos marrë përgjigje, Përgjegjësi i Sektorit të IT, i shkruan sërish ankuesit duke kërkuar ta vërë në dijeni a e ka realizuar detyrën e ngarkuar. Pas disa e-maileve të dërguara, Përgjegjësi i Sektorit të IT, ja ngarkon detyrën e B. M. një specialisti tjetër, duke qënë se ai nuk kishte arritur ta përfundonte.

Më pas, më datë 11.06.2020, ankuesi i drejtohet me e-mail Përgjegjësit të Sektorit të tij duke i thënë të ndalë gjuhën diskriminuese dhe të normalizohen raportet ndërmjet tyre, duke e trajtuar në mënyrë të barabartë me kolegët e tij.

Në përgjigje të ankuesit, në po të njëjtën ditë, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së, i kthen përgjigje me e-mail duke i sqaruar se për asnjë moment nuk është ushtruar diskriminim ndaj tij dhe ndër të tjera e fton që detyrat e ngarkuara të mos i zvarrisë, por t'i kryejë.

Përsa më sipër dhe në analizë të informacionit të vënë në dispozicion nga ana e palëve, evidentohet se mes ankuesit dhe Përgjegjësit të Sektorit të IT-së, ka patur një situatë të tensionuar, por nuk konstatohet që si rezultat i saj të ketë ardhur si pasojë trajtimi i pabarabartë i ankuesit në raport me kolegët e tij.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është ekspozuar përpara një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së.

e) Lidhur me ananlizën e Performancës në Punë të ankuesit për vitet 2017-2018-2019.

Në analizë të Vlerësimeve të Performacës në tre vitet 2017-2018-2019, ankuesi në tërësinë e tyre është vlerësuar me një nivel mesatar. Sa i përket Treguesve të Performacës së ankuesit të vitit 2018, ka një vlerësim ***Mjaftueshëm dhe Jo mjaftueshëm***, lidhur me: *informon të tjerët rregullisht, përdor metodat e duhura të komunikimit, ofrimin ndihmë dhe mbështetje për kolegët, punon përmes bashkëpunimit në situata pune në grup, punon aktivisht për të zgjidhur konfliktet, përkushtohet për të dhënë maksimumin në punë etj.*

Sa i përket Treguesve të Performacës së ankuesit të vitit 2019, ka një vlerësim ***Mjaftueshëm***, lidhur me: *ofrimin ndihmë dhe mbështetje për kolegët, punon përmes bashkëpunimit në situata pune në grup, punon aktivisht për të zgjidhur konfliktet etj.*

Në përfundim të tij, ka cilësuar se nuk ka qënë dakord me vlerësimin, por nuk është vënë në dispozicion asnjë fakt që ai ka kundërshtuar administrativisht vlerësimet e performancës

Nga analiza e vlerësimeve të sipërcituara dhe informacioni i administruar rezulton që ankuesi ka patur një vlerësim performance mesatar gjatë 3 viteve të fundit nga ana e eprorëve të tij. Nga vlerësimi i tyre, Komisioneri konstaton se ato kanë qënë thujse në të njëjtat nivele dhe nuk evidentohet se kanë patur ndonjë ndryshim të dukshëm.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është ekspozuar përpara një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, rezulton se:

- Masat disiplinore të marra ndaj tij janë të ligjshme;
- Nuk konstatohet në asnjë moment se kundërshtimi i marrjes në dorëzim të kontratës së prokurimit, ka sjellë pasoja të drejtëpërdrejta ndaj ankuesit;
- Pavarësisht faktit që ankuesi pretendon se me emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, TH. G., është trajtuar në mënyrë diskriminuese, ky pretendim nuk rezultoi i provuar apo mbështetur në provat e administruara.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se punëdhënësi i B. M., Radio Televizioni Shqiptar nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj tij, ose që kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e radio Televizionit Shqiptar, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit B. M. nga ana e Radio Televizionit Shqiptar për shkak të bindjeve politike dhe kundërshtimit të eprorëve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindja politike dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Punësim)